

Indeksi i Çmimeve të Konsumit


Dhjetor 2025

Tiranë, më 09 Janar 2026: Indeksi i Çmimeve të Konsumit në muajin Dhjetor 2025, arriti 120,9, kundrejt muajit Dhjetor 2020¹.

Ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Dhjetor 2025 është 2,3 %, një vit më parë ky ndryshim ishte 2,1 %. Ndryshimi mujor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Dhjetor 2025, krahasuar me Nëntor 2025 është 0,7 %.

Rritja mesatare vjetore e çmimeve të konsumit në vitin 2025 është 2,2 %, njësoj si një vit më parë.

Fig. 1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të çmimeve të konsumit (%)




Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të indeksit të çmimeve të konsumit.

Rritja vjetore e çmimeve në muajin Dhjetor është ndikuar kryesisht nga grupi “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me +0,96 pikë përqindje, pasuar nga grupi “Ushqime dhe pije joalkoolike” me +0,56 pikë përqindje. Gjithashtu, çmimet e grupit “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” ndikuan me +0,16 pikë përqindje, çmimet e grupit “Hotele, kafene dhe restorante” me +0,15 pikë përqindje, çmimet e grupit “Pije alkoolike dhe duhan” me +0,11 pikë përqindje, çmimet e grupit “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me +0,10 pikë përqindje, çmimet e grupit “Argëtim dhe kulturë” me +0,08 pikë përqindje, çmimet e grupit “Shërbimi arsimor” me +0,06 pikë përqindje, çmimet e grupit “Komunikimi” me +0,03 pikë përqindje, çmimet e grupeve “Veshje dhe këpucë”, “Shëndeti” dhe “Transporti” me +0,02 pikë përqindje secili.

¹ Duke filluar nga indeksi i muajin Janar 2026, përllogaritja Indeksit të Çmimeve të Konsumit do të bëhet me klasifikimin e ri ECOICOP versioni 2.

Fig. 2 Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor



Ndryshimet vjetore të grupeve kryesore: Krahasuar me muajin Dhjetor 2024, rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me 4,8 %, pasuar nga grupet “Argëtim dhe kulturë” me 3,6 %, “Hotele, kafene dhe restorante” me 2,6 %, “Pije alkoolike dhe duhan” me 2,2 %, “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” me 2,1 %, “Shërbimi arsimor” dhe “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me 1,9 % secili, “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 1,6 %, “Komunikimi” me 0,9 %, “Shëndeti” me 0,5 %, “Veshje dhe këpucë” me 0,4 % dhe “Transporti” me 0,3 %.

Brenda grupit të ushqimeve çmimet e nëngrupit “Qumësht, djathë dhe vezë” patën një rritje me 4,4 %, pasuar nga nëngrupet “Peshk” dhe “Vajra dhe yndyrna” me 3,8 % secili, “Mish” me 2,3 %, “Fruta” me 0,4 %, etj.

Ndryshimet mujore të grupeve kryesore: Krahasuar me muajin Nëntor 2025, çmimet e grupit “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 1,1 %, pasuar nga grupet “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me 0,9 %, “Argëtim dhe kulturë” me 0,8 %, “Pije alkoolike dhe duhan”, “Hotele, kafene dhe restorante” dhe “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me 0,4 % secili, “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” me 0,3 %, “Veshje dhe këpucë” dhe “Transporti” me 0,1 % secili.

Tab. 1 Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Dhjetor 2020=100

Kodi	Grupet	Peshat	12-24	01-25	02-25	03-25	04-25	05-25	06-25	07-25	08-25	09-25	10-25	11-25	12-25
	Gjithsej	100	118,3	118,7	119,1	119,7	119,8	119,5	119,2	119,1	119,5	120,3	120,3	120,1	120,9
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	34,3	133,4	134,7	135,9	137,4	137,4	135,7	134,5	133,1	133,5	134,6	134,7	134,1	135,6
2	Pije alkoolike dhe duhan	4,9	116,7	116,9	117,6	117,8	117,9	117,9	117,9	118,1	118,5	118,8	118,8	118,8	119,3
3	Veshje dhe këpucë	3,9	112,9	112,5	111,9	112,0	111,9	111,9	111,6	111,1	111,5	112,6	113,8	113,3	113,4
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	20,1	108,5	108,4	108,1	108,6	108,8	109,4	109,7	111,0	111,5	112,7	112,6	112,7	113,6
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	7,5	117,4	117,8	118,0	117,9	117,9	118,4	118,5	118,2	118,7	119,0	119,4	119,5	119,9
6	Shëndeti	3,5	104,4	104,4	104,6	104,6	104,5	104,6	104,6	104,4	104,6	104,8	104,9	104,9	104,8
7	Transporti	6,1	108,7	108,7	108,8	108,9	108,9	109,2	109,5	109,6	109,8	109,6	109,1	108,9	109,0
8	Komunikimi	3,0	106,2	106,2	106,2	106,4	106,5	106,7	106,7	106,7	106,8	106,9	107,0	107,1	107,1
9	Argëtim dhe kulturë	2,3	117,5	117,8	118,8	120,3	120,3	121,0	121,6	122,0	122,6	123,0	121,7	120,7	121,7
10	Shërbimi arsimor	3,4	106,0	106,1	106,1	106,1	106,1	106,1	106,1	106,1	106,1	108,2	108,1	108,1	108,1
11	Hotele, kafene dhe restorante	5,7	115,6	115,6	115,8	115,9	116,0	116,1	116,2	117,0	117,6	117,9	118,0	118,0	118,5
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	5,6	108,2	108,5	108,7	108,7	108,8	108,7	108,8	108,9	109,1	109,5	109,8	109,8	110,2

Tab. 2 Ndryshimet vjetore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit

Kodi	Grupet	12-24/12-23	01-25/01-24	02-25/02-24	03-25/03-24	04-25/04-24	05-25/05-24	06-25/06-24	07-25/07-24	08-25/08-24	09-25/09-24	10-25/10-24	11-25/11-24	12-25/12-24
	Gjithsej	2,1	1,9	1,9	2,1	2,3	2,2	2,4	2,5	2,3	2,4	2,3	2,1	2,3
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	3,0	2,6	2,8	3,0	3,8	3,2	3,5	3,2	2,5	1,8	1,6	1,5	1,6
2	Pije alkoolike dhe duhan	3,8	3,9	4,5	4,4	3,9	3,7	3,5	3,4	3,3	3,4	3,1	2,9	2,2
3	Veshje dhe këpucë	3,8	3,3	2,8	3,0	2,7	2,5	1,8	0,9	0,6	1,1	1,8	0,6	0,4
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	0,9	0,9	0,4	0,9	1,1	1,5	1,8	3,0	3,1	4,1	4,3	4,0	4,8
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	4,2	3,9	3,6	3,5	3,2	3,2	3,0	2,7	2,8	2,6	2,9	2,8	2,1
6	Shëndeti	1,1	0,9	0,6	0,6	0,5	0,5	0,6	0,4	0,4	0,6	0,5	0,6	0,5
7	Transporti	-2,8	-2,5	-2,2	-2,5	-2,6	-1,2	-0,5	-0,4	0,5	0,4	0,5	0,8	0,3
8	Komunikimi	1,2	1,2	1,2	1,5	1,5	1,6	1,6	1,5	1,2	1,0	1,1	1,3	0,9
9	Argëtim dhe kulturë	5,6	5,7	6,5	7,4	6,3	6,3	6,8	7,7	6,3	4,7	3,2	2,6	3,6
10	Shërbimi arsimor	0,8	0,9	0,9	0,9	0,9	0,9	0,9	0,8	0,7	2,2	2,0	1,9	1,9
11	Hotele, kafene dhe restorante	1,8	1,7	1,8	1,9	1,7	1,8	1,7	2,0	2,2	2,5	2,4	2,3	2,6
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	1,5	1,6	1,4	1,3	1,3	1,1	1,2	1,2	1,2	1,5	1,7	1,6	1,9

%

Tab. 3 Ndryshimet mujore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit

%

Kodi	Grupet	12-24	01-25	02-25	03-25	04-25	05-25	06-25	07-25	08-25	09-25	10-25	11-25	12-25
	Gjithsej	0,6	0,4	0,3	0,6	0,1	-0,3	-0,2	-0,1	0,3	0,7	0,1	-0,2	0,7
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	0,9	0,9	0,9	1,2	0,0	-1,3	-0,9	-1,0	0,3	0,8	0,1	-0,4	1,1
2	Pije alkoolike dhe duhan	1,1	0,2	0,6	0,2	0,0	0,0	0,0	0,2	0,3	0,2	0,0	0,0	0,4
3	Veshje dhe këpucë	0,3	-0,3	-0,5	0,1	-0,1	0,0	-0,3	-0,4	0,3	1,0	1,0	-0,5	0,1
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	0,1	0,0	-0,3	0,5	0,2	0,5	0,3	1,2	0,5	1,0	-0,1	0,0	0,9
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	1,0	0,3	0,2	-0,1	0,0	0,4	0,0	-0,2	0,4	0,3	0,3	0,1	0,3
6	Shëndeti	0,2	0,1	0,1	0,0	-0,1	0,1	0,0	-0,2	0,1	0,2	0,1	0,0	0,0
7	Transporti	0,6	0,0	0,1	0,1	0,0	0,3	0,3	0,1	0,2	-0,2	-0,4	-0,2	0,1
8	Komunikimi	0,4	0,0	0,0	0,2	0,1	0,1	0,0	0,0	0,1	0,1	0,1	0,1	0,0
9	Argëtim dhe kulturë	-0,1	0,2	0,9	1,3	0,0	0,6	0,5	0,3	0,5	0,4	-1,1	-0,8	0,8
10	Shërbimi arsimor	0,0	0,1	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	2,0	-0,1	0,0	0,0
11	Hotele, kafene dhe restorante	0,2	0,0	0,2	0,1	0,0	0,1	0,0	0,7	0,5	0,3	0,1	0,0	0,4
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	0,1	0,3	0,2	0,1	0,1	-0,1	0,1	0,1	0,1	0,4	0,2	0,0	0,4

Metodologjia

Njoftim i rëndësishëm për përdoruesit

Duke filluar nga Shkurti 2026, me publikimin e indeksit të muajit Janar 2026, në përlogaritjen e indekseve të konsumit do të hyjnë në fuqi disa ndryshime metodologjike, si më poshtë:

- Indeksi i Çmimeve të Konsumit do të përlogaritet sipas Klasifikimit të ri Evropian të Konsumit Individual sipas Qëllimit, versioni 2 (ECOICOP 2);
- Periudha e referencës së indeksit do të përditësohet nga Dhjetor 2020=100 në Dhjetor 2025=100.

Ndryshime metodologjike

Në muajin Janar të çdo viti Indeksi i Çmimeve të Konsumit shoqërohet me disa ndryshime metodologjike sipas metodologjisë ndërkombëtare të llogaritjes së këtij treguesi, të cilat konsistojnë në:

- Përditësimin e peshave: Peshat e mallrave dhe shërbimeve janë ndryshuar duke u bazuar në shpenzimet mesatare të Anketës së Buxhetit të Familjeve 2023.
- Përditësimin e listës së mallrave dhe shërbimeve: Shporta përbëhet nga 331 produkte dhe shërbime.
- Përditësimin e listës së njësive tregtare ku mbledhen çmimet.

Indeksi i Çmimeve të Konsumit duke filluar nga muaji Janar 2021 llogaritet me bazën e re. Muaji Dhjetor 2020 shërben si periudhë bazë për llogaritjen e indeksit (Dhjetor 2020 = 100).

Përkufizime

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) është matësi zyrtar i inflacionit në Shqipëri, Indeksi mat ndryshimet relative të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve të përdorura nga familjet për konsum vetjak dhe llogaritet duke përdorur strukturën e konsumit final të familjeve shqiptare. Burimi kryesor i informacionit për shpenzimet është Anketa e Buxhetit të Familjeve.

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve midis muajit korrent me të njëjtin muaj të vitit të mëparshëm. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve korente në nivelin e çmimeve, por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të cilitdo muaj.

Ndryshimi mujor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të muajit korrent me muajin e mëparshëm, Ky tregues është i ndjeshëm nga efektet sezonale.

Ndryshimi mesatar 12 mujor mat ndryshimin e indeksit mesatar të konsumit në 12 muajt e fundit me indeksin mesatar të 12 muajve të mëparshëm.